



**FECH**  
Forum for Educational Change



# **(MOS) PËRGJEGJËSIA E KOMUNAVE PËR TË RINJTË,**

**NËN LLUPËN E FNA-SË**

**BOTUES:**

Forumi për Ndryshime në Arsim  
Rr.Illindenska numër.87/13, Tetovë, Maqedonia e Veriut.  
Fech.mk@gmail.com  
Ardit.ramadanni@gmail.com

**AUTOR&REDAKTOR:**


Ardit Ramadani

**DIZAJN:**

Rina Abdullai

**VITI I BOTIMIT:**

2023







PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA

**1**

**Parathënie**

**4**

**2**

**Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore**

**5-7**

**3**

**Metodologjia**

**8-11**

**4**

**Komuna e Dibrës**

**12-14**

**5**

**Komuna e Gostivarit**

**15-17**

**6**

**Komuna e Kumanovës**

**18-20**

**7**

**Komuna e Manastirit**

**21-23**

**8**

**Komuna e Tetovës**

**24-26**

**9**

**Rekomandime dhe Konkluzione**

**27**



# PARATHËNIE

Pse ky hulumtim?



Monitorimi i implementimit të ligjit për pjesëmarrje dhe politika rinore, është një hulumtim domethënës dhe kuptimplotë, që duhet të zë vend të rëndësishëm për të gjithë palët që kanë interes të kenë informacion shtesë rreth zbatimit të Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Forumi për Ndryshime në Arsim, duke qenë koherent në kauzën e arsimit cilësor dhe fuqizimit të të rinjve, në vazhdimësi vë në dukje domosdoshmërinë e pjesëmarrjes të të rinjve në proceset vendimmarrëse në të gjitha nivelet e organizmit shtetëror.

Ligji për pjesëmarrje dhe politika rinore është një testament i fuqishëm i përkushtimit të pushtetit ligjvënës dhe atij ekzekutiv, për t'ju ofruar të rinjve struktura për t'u dëgjuar, vlerësuar dhe angazhuar në formësimin e tyre. Megjithatë, jemi të vetëdijshëm se ekzistenca thjeshtë e një ligji nuk garanton zbatimin efektiv të tij. Prandaj, ky hulumtim na shërben si një pasqyrë e gjendjes aktuale të zbatueshmërisë së dispozitave ligjore, duke identifikuar çështjet që duhet adresuar dhe duke propozuar rekomandime për përmirësimin e zbatueshmërisë dhe funksionalizimit të ligjit.

Aktivisti dhe gazetari **Ardit Ramadani**, njëherësh autori i hulumtimit, na sjell të dhëna thelbësore për Monitorimin dhe Implementimin e Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Ky hulumtim ofron një përmbledhje të rëndësishme të të dhënave të verifikuara, që përshkruajnë dhe analizojnë kujdesshëm situatën aktuale të pjesëmarrjes së të rinjve dhe zbatimin e politikave rinore.

Duke i patur për bazë burimet e këtij hulumtimi, dëshirojmë të nxisim një debat të frytshëm dhe të qëndrueshëm në këtë segment të ndjeshëm dhe të rëndësishëm për të ardhmen e të rinjve dhe zbatueshmërisë të ligjit.

Blend Hodai

Drejtor ekzekutiv i  
Forumit për Ndryshime në Arsim

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Blend Hodai".

# LIGJI PËR PJESËMARRJE DHE POLITIKA RINORE

Kur, çka, si dhe pse?

*Shkurt e qartë: Ligji u votua më 14 janar të vitit 2020, nga atëherë deri sot – realizimi i tij nga institucionet përkatëse lë për të dëshiruar.*

Për shkak të sfidave të mëdha me të cilat përballen në vazhdimësi të rinjtë në Maqedoninë e Veriut dhe nevoja imanente për të ju gjetur zgjidhje, pushteti ligjvënës tash më shumë se një dekadë ka tentuar që zgjidhja e disave prej këtyre problemeve të rregullohet edhe përmes dispozitave ligjore. Fillimisht ky proces u tentua të realizohet në vitin 2011 pas kërkesave të vazhdueshme të sektorit të rinisë – i cili fillimisht u pranua nga autoritetet kompetente, u përgatit një propozim-ligj, i cili edhe pse ishte shumë i diskutueshëm fillimisht për formën se si u realizua, në fund dështoi dhe u tërhoq duke mos mundur që i njëjti të del para deputetëve për t'a votuar ose jo.

Pas shtatë vitesh që propozim-ligji flejti në sirtaret e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Më në fund në vitin 2018, me iniciativë të Klubit për Çështje dhe Politika Rinore u përveshën krahët për të inicuar një rregullim ligjor për të rinjtë, të cilit më pas ju vendos emri Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Kësaj radhe, për dallim nga viti 2011, ishte e dukshme që autoritetet e kishin marrë më seriozisht këtë punë, por jo vetëm për shkak të dëshirës së madhe të tyre për t'i rregulluar ligjërisht nevojat dhe sfidat e të rinjve, por edhe nga presioni i vazhdueshëm që vinte nga organizatat e shoqërisë civile, të cilët mes tjerash kërkonin që të jenë të përfshirë në secilën fazë të përgatitjes të këtij ligji si dhe që i njëjti, të jetë në përputhje me ato të shteteve të Bashkimit Evropian, praktika ligjore të cilat kishin rezultuar të suksesshme në këtë drejtim.

Menjëherë pas shpalljes së iniciativës nga ana e Klubit të Deputetëve të Rinj filloi edhe procesi i krijimit të ligjit me çka u formua një grup pune ekspertësh, të cilët në përbërje kishin përfaqësues të ndryshëm të sektorit të të rinjve dhe persona të cilët në dorë të parë kishin punuar me të rinj, qoftë në nivel kombëtar apo lokal. Por përveç ekspertëve, në këtë grup të punës të ekspertëve kishte edhe persona zyrtarë, të zgjedhur nga populli si dhe të emëruar nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, edhe atë: Deputetë, anëtarë të forumeve-rinore të të gjitha partive politike në vend si dhe për të dhënë kontributin e tyre bazuar në praktikën e shteteve amë, kishte edhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare, kishte anëtarë të Këshillit Rinor Kombëtar, që është një rrjet i organizatave rinore me çka pesë përfaqësuesit e këtij rrjeti në këtë grup të punës synonin t'i përfaqësojnë kërkesat e të gjitha organizatave anëtarë të këtij këshilli, të cilët për hir të së vërtetës dhanë kontributin më të madh në përpilimin e këtij ligji.

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë së Veriut arriti që për një periudhë jo të gjatë kohore të realizojë gjithsej 17 konsultime me organizata rinore dhe të rinj në nivel lokal, me qëllim që nga ata të merr informacione të detajuara në lidhje me nevojat, sfidat dhe problematikat me të cilat përballen ato dhe të cilat rrjedhimisht, duhet përfshirë në Ligjin për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Kështu, u arritë që të përcaktohen nevojat e të rinjve dhe kërkesat të cilat ata dëshironin të inkorporohen me doemos në këtë ligj, i cili do të ishte i pari në historinë e Maqedonisë së Veriut që do të merrej ekskluzivisht dhe vetëm me çështjet rinore dhe formave të zgjidhjes së tyre duke i obliguar institucionet kompetente të ndërmarrin hapa konkret në këtë drejtim.

Më në fund, pas një punë intensive të sektorit rinor, partnerëve ndërkombëtarë dhe të gjithë palëve relevante, u arrit një konsensus nga të gjithë palët i cili rezultoi që më 14 janar të vitit 2020 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratohet ligji i cili u titullua “Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore”. Miratimi i këtij ligji u pa si një ndër hapat më të rëndësishme për të rinjtë në vend pasi për herë të parë në historinë e Maqedonisë së Veriut nga pavarësia, u krijua një zgjidhje ligjore e cila do të garantonte pjesëmarrjen e të rinjve në procese të rëndësishme si dhe do t’i njihje edhe zyrtarisht të gjitha format e organizimit të të rinjve, gjë që në të kaluarën kishte qenë problem për grupet e të rinjve të cilët në forma të ndryshme kishin tentuar të organizohen për kauzat e tyre. Përmes kësaj zgjidhje ligjore, tashmë ligjërisht bëhej dallimi ndërmjet një organizate rinore, një organizate për të rinjtë dhe një organizatë ombrellë rinore ndërsa institucioni i cili sipas këtij ligji u mvesh me obligimin për të mbajtur një Regjistër për format e organizimit rinor, ishte Agjencia për Rini dhe Sport. Zyrtarisht tashmë nga miratimi i këtij ligji përcaktohet edhe se kush mund të konsiderohet si person i ri, çfarë janë politikat rinore, puna rinore dhe punëtori rinor ndërsa obligon institucionet shtetërore dhe lokale që të përfshijnë brenda tyre mekanizma për përfshirjen e të rinjve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarjes – edhe atë në nivel kombëtar, Trupi Këshillimor Kombëtar për Politika Rinore ndërsa në nivel lokal Këshillat Rinorë Lokal në të gjitha komunat e Republikës së Maqedonisë së Veriut.


Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore në nivel kombëtar e obligon Qeverinë e Maqedonisë së Veriut që të ndajë çdo vit mjete në vlerë prej së paku 0.3% për nevojat e tij ndërsa në nivel lokal, komunat e vendit obligohen që të për të rinjtë ndahen mjete vjetore prej më së paku 0,1% në vit. Si dokument kryesore tek të cilat institucionet përkatëse duhet të bazohen në drejtim të implementimit të këtij ligji është Strategjia Kombëtare për të Rinjtë e cila në atë kohë u miratua për vitet 2016-2025 ndërsa për shkak se e njëjta stagnoi në realizim, për shkak të formës jo të mirë të përpilimit të saj, në prag të miratimit është Strategjia e re Kombëtare për të Rinjtë për vitet 2023-2027 e cila është punuar nga të gjitha institucionet rinore në vend, bashkësia ndërkombëtare dhe në konsultim me organizatat joqeveritare të cilat kanë në fokus të rinjtë dhe çështjet rinore. Përveç strategjisë në nivel kombëtar, dokument tejet i rëndësishëm është edhe Strategjia Lokale Rinore e cila votohet në këshillat komunale. Këto janë dokumente strategjike të cilat përcaktojnë të gjitha prioritetet afatmesme për promovimin dhe realizimin e politikave rinore, interesave të të rinjve ndërsa vlejné në një afat prej pesë vitesh ndërsa Strategjia Rinore Lokale duhet patjetër të jetë e harmonizuar me atë kombëtare, rrjedhimisht, me miratimin e strategjisë së re kombëtare për të rinjtë do të duhet që të gjitha komunat e vendit t'i rinovojné strategjitë e tyre rinore lokale dhe më pas të njëjtat përsëri të votohen në Këshillat Komunal.

Në qoftë se ligji do të realizohej në përpikmëri nga të gjitha palët, por sidomos institucionet publike – qofshin ato në nivel nacional apo lokal, të rinjtë në vend do të gëzonin shumë përfitime, zhvillim më të lehtë të ideve të tyre si dhe kujdes të veçantë ndaj nevojave dhe sfidave të të rinjve. Por megjithatë, nga miratimi i ligjit deri sot zbatimi i tij lë shumë për të dëshiruar, pjesa më e madhe e institucioneve nuk i përmbushin obligimet të cilat rrjedhin nga ky ligj ndërsa një pjesë tjetër i kryejné këto obligime ligjore sa për sy e faqe. Komunat me theks të veçantë janë institucionet të cilat kryesisht neglizhojnë Ligjin për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore, duke mos i kushtuar rëndësi obligimeve të cilat rrjedhin nga ky ligj.

## METODOLOGJIA


### Çfarë bëmë ne?

Përpos institucioneve shtetërore, rol të rëndësishëm në zbatimin e këtij ligji ka edhe vetëqeverisja lokale në vend. Andaj, objekt i këtij hulumtimi është zbatimi i Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore dhe obligimeve që rrjedhin nga ai, nga ana e pesë komunave të Maqedonisë së Veriut, edhe atë:



Hulumtuesi i Forumit për Ndryshime në Arsim ka siguruar informacione përmes kërkesës për qasje të lirë në informacione me karakter publik nga ana e komunave të cilat kanë qenë objekt i hulumtimit dhe përpos kësaj, si burime alternative janë marrë edhe organizatat rinore dhe ato për të rinjë që funksionojnë në kuadër të komunave përkatëse të lartëpërmendura, e gjithë kjo me qëllim që të shihet se sa nga obligimet ligjore nga Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore janë zbatuar nga këto komuna dhe se sa seriozisht i marrin nevojat dhe sfidat e të rinjve administratat komunale të komunave përkatëse.

Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore në vetvete përmban gjithsej 27 nene dhe mvesh me obligime të ndryshme një sërë institucionesh në nive l nacional dhe lokal. Hulumtuesi i Forumit për Ndryshime në Arsim ka monitoruar vetëm nenet ku obligimin për zbatimin e tyre i kanë institucionet e vetëqeverisjes lokale, me theks të veçantë komunat të cilat kanë qenë objekt i këtij studimi. Këto janë nenet të cilat komunat e vendit kanë qenë të obliguara t'i zbatojnë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe të cilat kanë qenë objekt i këtij hulumtimi.



## KËSHILLAT LOKALË TË TË RINJVE

### *Formimi i këshillave i lokalë të të rinjve*

#### **Neni 16**

- 1) Komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit me statut parashohin formim të këshillave lokalë të të rinjve.
- 2) Këshillat lokalë të të rinjve kanë rol këshillëdhënës dhe përfaqësues në komuna, komuna në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit nga fushëveprimi i çështjeve dhe politikave të të rinjve.

## QENDRA PËR TË RINJ

#### **Neni 22**


- 1) Qendrat për të rinj janë vende ku përgatiten dhe zbatohen programe që e përmirësojnë mirëqenien e të rinjve, zhvillimin e jetës personale, sociale dhe profesionale të të rinjve, informacione me interes të rëndësishëm për të rinj dhe aspekte të tjera nga jeta të rinjve.
- 2) Për punë me të rinj në qendrat për të rinj përgjegjës janë punëtorët e të rinjve.
- 3) Qendrat e të rinjve themelohen në bashkëpunim ndërmjet komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit dhe format e të rinjve të organizimit të rregulluara me këtë ligj.

## STRATEGJIA LOKALE E TË RINJVE

#### **Neni 20**

- 1) Strategjia lokale e të rinjve është dokument strategjik me të cilin, në pajtim me Strategjinë nacionale të të rinjve, përcaktohen qëllimet dhe përparësitë afatmesme për zhvillimin e politikave të të rinjve dhe promovimin e interesave të të rinjve dhe përcaktohen masa organizative, financiare dhe administrative për realizimin e tyre.
- 2) Strategjia lokale përmban edhe Plan aksional për realizim me aktivitete, dinamikë të definuara, bartës të aktiviteteve dhe projekte të mjeteve buxhetore, si dhe kushte dhe indikatorë për evalvimin e zbatimit të Strategjisë lokale të të rinjve.
- 3) Strategjinë lokale të të rinjve e miraton Këshilli i komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit për periudhë prej pesë vitesh.





## ZYRA PËR TË RINJ

### Neni 21

- 1) Komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit formojnë zyra për të rinj nga ku koordinohet puna për të rinj në komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit dhe paraqet pikë primare për qasje për të rinj në nivel lokal.

## NËPUNËS PËR TË RINJ

### Neni 23

- 1) Organet e administratës shtetërore, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit janë të detyruar të caktojnë administrator për të rinj, person përgjegjës për punën e Zyrës për koordinim, zbatim dhe përcjelljen e çështjeve me interes të të rinjve në fushëveprimin e kompetencave të institucionit.
- 2) Nëpunësit për të rinj nga paragrafi (1) i këtij neni, përgatisin raport vjetor për punën e institucioneve në fushëveprimin e të rinjve që i parashtrojnë te Agjencia e Rinisë dhe Sportit dhe i publikojnë në ueb-faqen e organeve të administratës shtetërore, komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

## FINANCIMI

### Neni 25

- 1) Për zbatimin e këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në vit ndahen mjete në lartësi prej së paku 0,3%.
- 2) Nga buxhetet e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit për të rinjtë ndahen së paku 0,1% në nivel vjetor.

Hulumtimi është realizuar në një periudhë prej muajit maj – korrik 2023 dhe deri në publikimin e këtij hulumtimi nuk përjashtohet mundësia që gjendja në zbatimin e dispozitave ligjore që rrjedhin nga Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore në ndonjërin prej komunave që ka qenë objekt i hulumtimit tonë të kishte ndryshuar.

Forumi për Ndryshime në Arsim nuk mund të garantojë se gjendja me zbatimin e ligjit nga ana e komunave të lartëpërmendura në momentin e publikimit të hulumtimit është plotësisht e tillë, përkatësisht siç thuhet në këtë hulumtim. Të dhënat do të prezantohen sipas rendit alfabetik të qyteteve.

Forumi për Ndryshime në Arsim në vazhdimësi do të monitorojë zbatimin e Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore nga vetëqeverisja lokale në Maqedoninë e Veriut. Ky është publikimi i parë dhe i ka nën llupë pesë komunat e lartëpërmendura ndërsa hulumtimi për pesë komuna tjera do të publikohet për një periudhë të shkurtër kohore.

## KOMUNA E DIBRËS



### **KU NDODHET DIBRA, SA TË RINJ KA DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ZBATIMI I KËTIJ LIGJI?**

Dibra shtrihet në pjesën perëndimore të Maqedonisë së Veriut dhe ka gjithsej 15,412 popullsi rezidente, prej të cilëve 3,284 janë të rinj, që përbën 5 për qind të popullsisë së përgjithshme andaj është shumë e rëndësishme që obligimet ndaj tyre të realizohen. Mijëra të rinjë kanë lëshuar këtë qytet nga regjistrimi i parafundit në vitin 2002, kur numri i të rinjve ishte gjithsej 5,216.

## QENDRA RINORE

### NENI 22

Të rinjtë e Dibrës nuk kanë një hapësirë ku mund përgatisin dhe zbatojnë programe në të mirë të tyre, qofshin ato sociale, profesionale apo aspekte të tjera të jetës rinore. Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore i obligon komunat që brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të themelojnë më së paku një Qendër Rinore.



## KËSHILLI RINOR LOKAL

### NENI 16

Në komunën e Dibrës të rinjtë nuk kanë përfaqësues të tyre të cilët sipas Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore do të kishin rol këshillues dhe avokues për çështjet me interes të të rinjve. Autoritetet komunale i thanë Forumit për Ndryshime në Arsim se janë në proces të ndryshimit të Statutit që do të ju lejonte themelimin e këtij trupi.



## ZYRA RINORE/NËPUNËSI RINORE

### NENI 21/23

Të rinjtë në Dibër nuk kanë një zyrë e cila sipas Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore do t'i koordinonte të gjitha çështjet që janë në interes të të rinjve. Në Dibër gjithashtu nuk ka nëpunës për të rinjtë.



## STRATEGJIA RINORE LOKALE

### NENI 20

Në Dibër nuk ka një dokument strategjik i cili do të përcaktonte synimet dhe prioritet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave rinore në nivel lokal, ashtu siç e kërkon Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore.



## BUXHETI VJETOR PËR TË RINJTË

### NENI 25

Në buxhetin vjetor të komunës së Dibrës nuk ndahen më së paku 0,1% buxhet për nevojat e të rinjve, ashtu siç e kërkon Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore.






HEKURAN DUKA

**“SHUMË KEQ!”**

**1**

## KOMUNA E GOSTIVARIT



### KU NDODHET GOSTIVARI, SA TË RINJ KA DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ZBATIMI I KËTIJ LIGJI?

Gostivari shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë së Veriut dhe ka gjithsej 59,770 popullsi rezidente, prej të cilëve 11,610 janë të rinj që përbën 19 për qind të popullsisë së përgjithshme. Zbatimi i këtij ligji në këtë komunë është shumë i rëndësishëm pasi nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2002, Gostivari ka humbur mijëra të rinj, përkatësisht në atë kohë numri i të rinjve ishte 20,978 ndërsa ekzodi rrezikon të thellohet.

## QENDRA RINORE

### NENI 22

Në Gostivar funksionojnë tre Qendra Rinore por asnjëra prej tyre nuk është e themeluar ashtu siç e kërkon Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Autoritetet komunale aktualisht janë në procedurë të regjistrimit të njërës prej tyre ashtu siç e kërkon ligji.



## KËSHILLI RINOR LOKAL

### NENI 16

Në komunën e Gostivarit është themeluar Këshilli Rinor Lokal në Maj të vitit 2023. Ky trup i të rinjve përbëhet nga gjithsej 11 anëtarë, edhe atë aktivist të organizatave joqeveritare dhe forumeve rinore të partive politike. Deri tani asnjë aktivitet nuk është realizuar nga Këshilli Rinor Lokal i komunës së Gostivarit.



## ZYRA RINORE/NËPUNËSI RINORE

### NENI 21/23

Në komunën e Gostivarit janë caktuar dy nëpunëse rinore, edhe atë Azra Nuredini dhe Afërdita Lutviu. Ato gjithashtu figurojnë në listën zyrtare të nëpunësve rinor të publikuar nga Agjencia për Rini dhe Sport. Në Gostivar ka zyrë rinore në të cilën punojnë dy nëpunëset rinore.



## STRATEGJIA RINORE LOKALE

### NENI 20

Në komunën e Gostivarit nuk ka Strategji Rinore Lokale, që është një ndër dokumentet më të rëndësishme për implementimin e Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Aktualisht Këshilli Rinor Lokal po punon në krijimin Strategjisë Rinore Lokale.



## BUXHETI VJETOR PËR TË RINJTË

### NENI 25

Në komunën e Gostivarit nuk ndahet buxhet vjetor për të rinjtë ashtu siç e kërkon Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Megjithatë, ka të destinuara mjete buxhetore për të rinjtë në fusha të ndryshme.





ARBEN TARAVARI

**“MJAFTUESHËM!”**

**3**



## KOMUNA E KUMANOVËS



### **KU NDODHET KUMANOVA, SA TË RINJ KA DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ZBATIMI I KËTIJ LIGJI?**

Kumanova gjendet në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë së Veriut dhe ka gjithsej 98,104 popullsi rezidente, prej të cilëve 18,720 janë të rinj, që përbën gjithsej 19 për qind të popullsisë së përgjithshme. Krahasuar me regjistrimin e popullsisë në vitin 2002, Kumanova ka humbur më shumë se 7 mijë të rinj ndërsa këto shifra nuk kanë alarmuar autoritetet.

## QENDRA RINORE

### NENI 22

Në Komunën e Kumanovës ka një Qendër Rinore dhe është ndër hapësirat e para rinore që është hapur në Maqedoninë e Veriut, bazuar në Ligjin për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Të rinjtë në Kumanovë organizojnë aktivitetet e tyre në hapësirat e kësaj qendre.



## KËSHILLI RINOR LOKAL

### NENI 16

Komuna e Kumanovës nuk ka themeluar Këshill Rinor Lokal ashtu siç e kërkon Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Autoritetet komunale na thanë se aktualisht janë në procedurë të themelimit të këtij trupi rinor brenda komunës.



## ZYRA RINORE/NËPUNËSI RINORE

### NENI 21/23

Si nëpunës rinor, komuna e Kumanovës nga maji i vitit 2021 e ka caktuar Martin Krstiq i cili koordinon çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë në këtë komunë. Në këtë komunë gjithashtu ka një zyrë rinore, e cila ndodhet në rrugën Tode Mendol me numër 22.



## STRATEGJIA RINORE LOKALE

### NENI 20

Në komunën e Kumanovës ende nuk ka Strategji Rinore Lokale i cili do të përcaktonte prioritetet e të rinjve në këtë vend. Në buxhetin e vitit 2023 janë ndarë mjete financiare për krijimin e kësaj strategjia ndërsa e njëjta do të realizohet në bashkëpunim me organizatat joqeveritare lokale.



## BUXHETI VJETOR PËR TË RINJTË

### NENI 25

Në Kumanovë ndahet buxhet vjetor për të rinjtë në vlerë prej 1,000,000 denarëve, prej të cilave 600,000 për funksionimin dhe mirëmbajtjen e Qendrës Rinore ndërsa tjerat për funksionimin e Zyrës Rinore dhe krijimin e Strategjisë Rinore Lokale.





MAKSIM DIMITRIEVSKI

**“MJAFTUESHËM!”**

**3**

## KOMUNA E MANASTIRIT



### **KU NDODHET MANASTIRI, SA TË RINJ KA DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ZBATIMI I KËTIJ LIGJI?**

Manastiri ndodhet në pjesën jugore të Maqedonisë së Veriut dhe ka gjithsej 85,162 popullsi rezidente, prej të cilëve 13,320 janë të rinj që përbën gjithsej 16 për qind të popullsisë së përgjithshme. Në regjistrimin e vitit 2002, në Manastir ishin regjistruar 20,665 të rinj ndërsa të rinjtë ikin nga ky qytet çdo ditë e më shumë.

## QENDRA RINORE

### NENI 22

Në Manastir, në vitin 2023 është hapur një Qendër Rinore në përputhje me standardet e Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Në këtë qendër zbatohen programe për përmirësimin e mirëqënies së të rinjve në këtë komunë, zhvillimin e jetës personale, sociale dhe profesionale të tyre.



## KËSHILLI RINOR LOKAL

### NENI 16

Në komunën e Manastirit është themeluar Këshilli Rinor Lokal në vitin 2022. Ky trup përbëhet nga aktivistë të organizatave joqeveritare dhe anëtarë të forumeve rinore të partive politike.



## ZYRA RINORE/NËPUNËSI RINORE

### NENI 21/23

Në komunën e Manastirit në dhjetor të vitit 2021 është caktuar një nëpunës rinor. Ai është përgjegjës për Zyrën Rinore të kësaj komune dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me të rinjtë në këtë vend. Nëpunësi rinor figuron edhe në listën zyrtare të Agjencisë për Rini dhe Sport.



## STRATEGJIA RINORE LOKALE

### NENI 20

Komuna e Manastirit ka kirjuar Strategji Rinore Lokale për vitet 2023-2027 në të cilën janë përcaktuar synimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave të të rinjve.



## BUXHETI VJETOR PËR TË RINJTË

### NENI 25

Komuna e Manastirit për vitin 2023 ka ndarë buxhet për të rinjtë në vlerë prej 2.100.000.00 denarë, prej të cilave 100.000.00 denarë për Këshillin Rinor Lokal, 900.000.00 denarë për Strategjinë Rinore Lokale, 600.000.00 denarë për Qendrën Rinore dhe 500.000.00 denarë për praktikën studentore.






TONI KONJANOVSKI

**“SHKËLQYESHËM!”**

**5**

## KOMUNA E TETOVËS



### KU NDODHET TETOVA, SA TË RINJ KA DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ZBATIMI I KËTIJ LIGJI?

Tetova ndodhet në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë së Veriut dhe ka gjithsej 84,770 popullsi rezidente, prej të cilëve 17,487 janë të rinj, që përbën 21 për qind të popullsisë së përgjithshme. Në regjistrimin e popullsisë të vitit 2002, në Tetovë kishte më shumë se 22,090 të rinj ndërsa rinia e këtij qyteti çdo ditë e më shumë largohet.

## QENDRA RINORE

### NENI 22

Komuna e Tetovës nuk ka të themeluar Qendër Rinore sipas standardeve dhe kritereve të Ligjit për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore. Aktualisht është në procedurë të regjistrimit të njëre prej hapësirave ekzistuese, ashtu siç e kërkon ligji.



## KËSHILLI RINOR LOKAL

### NENI 16

Këshilli Rinor Lokal është themeluar dhe funksionon në komunën e Tetovës. Ky trup i të rinjve është përbërë nga aktivistë të organizatave jo-qeveritare dhe anëtarë të forumeve rinore të partive politike dhe deri tani kanë realizuar disa aktivitete.



## ZYRA RINORE/NËPUNËSI RINORE

### NENI 21/23

Komuna e Tetovës ka përcaktuar një zyrë për të rinjtë por megjithatë nuk ka nëpunës rinor, i cili do të ishte përgjegjës për koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me të rinjtë në këtë komunë, pikërisht në zyrën për të rinjtë. Aktualisht kjo komunë është në procedurë e sipër të përcaktimit të nëpunësit rinor.



## STRATEGJIA RINORE LOKALE

### NENI 20

Komuna e Tetovës nuk ka përpiluar Strategji Rinore Lokale ashtu siç e kërkon Ligji për Pjesëmarrje dhe Politika Rinore ndërsa aktualisht është në procedurë e sipër të krijimit të këtij dokumenti i cili do të përcaktonte synimet dhe prioritetet afatmesme të të rinjve në nivel lokal, dhe i njëjti do të votohet në seancën e radhës të Këshillit Rinor Lokal.



## BUXHETI VJETOR PËR TË RINJTË

### NENI 25

Në buxhetin e vitit 2023 të komunës së Tetovës janë ndarë mjete financiare të cilat do të shfrytëzohen për aktivitete rinore. Megjithatë nuk dihet se sa mjete financiare janë ndarë dhe për çfarë specifikisht do të përdoren.







BILALL KASAMI

**“MJAFTUESHËM!”**

**3**

## KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

PËRKUNDËR QË KA TRE VITE NGA MIRATIMI I LIGJIT PËR PJESËMARRJE DHE POLITIKA RINORE, JO TË GJITHA KOMUNAT I KANË PËRMBUSHUR OBLIGIMET QË RRJEDHIN NGA KY LIGJ, QË ËSHTË MESAZH SE TË RINJTË NUK JANË PRIORITET I TYRE.

NJË PJESË E KOMUNAVE TË CILAT ISHIN OBJEKT I HULUMTIMIT TONË I KANË PËRMBUSHUR OBLIGIMET LIGJORE NGA LIGJI PËR PJESËMARRJE DHE POLITIKA RINORE VETËM FORMALISHT, NUK BËJNË ASGJË QË EDHE NË PRAKTIKË T'I JETËSOJNË KËTO OBLIGIME.

KOMUNAT DUHET QË TË VENDOSIN NË UEB-SAJTET E TYRE ADRESËN E ZYRËS RINORE SI DHE TË GJITHA KONTAKTET E NËPUNËSIT RINOR, PASI KOMUNAT PËRCAKTOJNË NËPUNËS RINOR, NDËRSA SHUMË PAK TË RINJ E DINË SE KUSH ËSHTË AI OSE AJO.

PËRVEÇ MANASTIRIT, ASNJËRA KOMUNË NUK KA TË PËRPILUAR STRATEGJI RINORE LOKALE, QË ËSHTË NDËR DOKUMENTET MË TË RËNDËSISHME I CILI PËRCAKTON SYNIMET DHE PRIORITETET E TË RINJVE NË KOMUNAT PËRKATËSE.

“MJETET BUXHETORE RINORE” TË MOS NDAHEN VETËM PËR KONCERTE DHE FESTIVALE, TË RINJTË KANË NEVOJË PËR SHKENCË, SPORT DHE FUSHA TJERA TË RËNDËSISHME.

KOMUNAT T'I PUBLIKOJNË NË UEB-SAJTIN E TYRE ÇDO CENT QË DESTINOHET DHE HARXHOHET DUKE U THIRRUR NË TË RINJTË DHE LIGJIN PËR PJESËMARRJE DHE POLITIKA RINORE, TË RINJTË MERITOJNË TA DINË SE PËR ÇFARË KONKRETISHT HARXHOHEN PARATË E DESTINUARA PËR ATA.

NUK MJAFTON VETËM THEMELIMI I KËSHILLEVE RINORE LOKALE, KY TRUP I TË RINJVE ËSHTË E NEVOJSHME QË TË JETË AKTIV, MË PRANË TË RINJVE DHE NEVOJAVE TË TYRE.

KËSHILLET RINORE LOKALE TË JENË MË LARG PARTIVE POLITIKE QË UDHËHEQIN NË KOMUNAT PËRKATËSE DHE MË AFËR TË RINJVE DHE PRIORITETEVE TË TYRE.

KOMUNA E DIBRËS NUK KA PËRMBUSHUR ASNJË OBLIGIM TË LIGJIT PËR PJESËMARRJE DHE POLITIKA RINORE, AUTORITETET KOMUNALE TË MARRIN MË SERIOZISHT TË RINJTË DHE NEVOJAT E TYRE.



**FECH**

Forum for Educational Change

[www.fech.mk](http://www.fech.mk)